

VENDIM
NR. 432, datë 3.6.2020

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
FINANCIVE DHE EKONOMISË, TË PRONËS ME EMËRTIMIN “TOKË ARË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të pronës me emërtimin “tokë arë”, me sipërfaqe 37 300 m², sipas kartelës së pasurisë dhe planit të rievimit bashkëlidhur, me institucion përdorues Qendrën Shumëfunktionale Kamzë.

2. Qëllimi i përdorimit të pronës nga institucioni përdorues është ofrimi i arsimit dhe formimi profesional.


3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Qendra Shumëfunktionale Kamzë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama









REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENSIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE E ASHK KAMEZ-VORE

AS. Prof.

Nr. 7565/1 Prot

Tiranë, më 08.10 2019

Lënda : Kthim Përgjigje

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE PUNËSIMIT
DREJTORIA E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr.10920/3 Prot datë 30.9.2019 , protokolluar pranë zyrave tona me Nr.7565 Prot datë 01.10.2019, ju bejme me dije si me poshte:

Nga verifikimi i planit të rilevimit të përcjellë prej jush, objektet e shkollës profesionale Kamëz , rezultojnë të jenë ndërtuar në pronën e cila prek në hartën tonë të zyrës pasurinë Nr.145/1 Z.K 2066 Vol.5 Fq.180 e llojit Arë me sipërfaqe 37300 e afishuar Shtet.

Ju faleminderit për mirëkuptimin !

DREJTOR

ARJON BISTRI

(Me urdhër me delegim)

ZV DREJTOR

INDRIT OSMANI



